



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahim	03.01.2024	12.01.2024	2023/1058

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.12.2023, OE “Naim Shuki B.I.”- Prizren, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1058, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Blerja e uniformave per personelin mjekesor, personelin teknik dhe qarshafa per te semurit” me nr. të prokurimit: "70010-23-5909-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SPITALI REGJIONAL - PRIZREN.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 50,301 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 16/06/2023

Hapja e ofertave: 06/07/2023

Vendimi i rivlerësimit i AK-së: 06/12/2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/1058 i dt:27.12.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Naim Shuki B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për të sëmurit**” me numër të prokurimit: “**70010-23-5909-1-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **SPITALI REGJIONAL - PRIZREN**

Duka e u Bazur ne Vendimin Autoritetit Kontraktues RIVLERSIM qe thote se ne Oe NPT
PRINTEKS NE VEndimin Auoriteti Kontraktues Rivlersimit
jemi eliminuar per arsye se keto 3 Pozicione nuke plotesojn Kushtet ANEKSI 1 Dosjejs
Tenderit

Poz.1 Uniformë për personelin medicinal me ngjyrë të bardhë,

- Pantallonat kanë material tjetër nga bluzat, nuk është materiali i njëjti (përmba poliestër

POZ.2 Uniforma për sallat e operacionit të gjelbërta bluza dhe pantallona

- Bluza është sipas specifikave të kërkuara, ndërsa pantallonat në përmbajtje dhe pershtaten ngjyrës dhe kualitetit të bluzave (duhet të jenë komplet me ngjyrë të

POZ.5 Jakë të gjatë dimri me mbishkrim në shpinë dhe logo e qepur në gjoks material poliestër 35% pamuk pjesë e brendshme me lë

- -Mungon mostra me mbishkrimin dhe logon e spitalit

Fillimisht ju sqarojmë se arsyeja e autoritetit kontraktues është e paqartë dhe e pakuptueshme për ne për faktin

nëse gabim ka mostra jonë pasi që nëse do të ishim të përgjegjshëm, AK-ja do ta sqaronte me fakte dhe argumente konkrete ku një gjë e tillë nuk ka ndodhur arsyetime krejtësisht të pa bazuara.

POZ1 Për matjet që kanë bërë komisioni nuk është profesional dhe nuk janë qertifikuar për matje tekstilit dhe nuk ka mundësi me dorë të kuptohet se sa është përqindja e Poliestër e sa Pamuk

POZ2 Dosje Tenderit Për matjet që kanë bërë komisioni nuk është profesional dhe nuk janë qertifikuar për matje tekstilit dhe nuk ka mundësi me dorë të kuptohet se sa është përqindja e materialeve & ngjyra e kërkuar në Aneksin 1 Dosjes Tenderit është vetëm Gjelbert (Nuk është specifikuar me numër ngjyrës apo Gjelbert e mbydhur ose hapur etj) Kështu që njëra dhe Materiali e përmbush kërkesën AK sipas Dosjes Tenderit ANEKSI 1

POZ5 Për LOGO në mosra nuk kemi hasur në asnjë Tender të kërkohej logoja të qepet në mosra përveç nëse jemi Fitues kërkohej mosra me llogo dhe ceket në Dosjen e tenderit ose kërkohej llogo të qepet veqanërisht në një material gjithashtu kërkohej në dosjen e tenderit (në të kundërtën në mosra kur qepen logoja për OE që eliminohen nuk kanë drejt të përdorin ato mosra sepse simbolizon një institucion dhe gjithashtu nëse OE kemi humbje dhe duhet të paguhet nga AK dhe ceket në Dosjen e tenderit, gjë e tillë nuk ka ndodhur me AK-n

(Kosovë egziston një institucion që licencuar dhe certifikuar për matje ERAMED në seli në Prishtinë për më shumë (LC - 014 ERAMED NTP Akreditacija i arm.gov.mk)

Dhe deklarojm se 3 POZICION qe kemi dorzuar Mosrat plotesojn kushtin e Aneksit1 Dosjes se tenderit dhe kerkojm te behet rivlersimi dhe te mos shkelet Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese

KRITERET PËR VLERËSIM

<p>Kapaciteti teknik dhe profesional</p> <p>Kërkesa 1. Projektet e natyrës së ngjajshme realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së ngjajshme duhet të jetë jo më e vogël se 75.000,00 € Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % të kapacitetit teknik dhe profesionale të referencave të natyrës së ngjajshme</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>DESHMIA 3. Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara gajte tri viteve të shkuara (nga data e njoftimit per kontrate) duke saktësuar furnizimet e Ofruara , shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur sherbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi shërben kopja e certifikatës ,kur sherbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij sherbimi shërben kopja e cdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sherbimit të till si dhe duhet te bashkangiten referenca te natyres se ngjajshme</p>
<p>Kërkesa 2. Mostrat e kërkuara sipas listës së Përshkrimit të cmimeve tek specifikat teknike të duhet të jenë të mbvllura në një paketim pa shenja dalluese të OE.</p>	<p>Kërkesa 2. OE duhet të sjellë mostrat të mbvllura me një paketim të veçant në datën e hapies së ofertave, mostrat e kërkuara duhet të jenë sipas specifikimeve teknike në përshkrimin e Cmimeve . Mostrat do të dorëzohen tek zyra e prokurimit nr 8 para hapies ofertave me këtë rast do të veprohet konform nenit 37 të rregullores Nr.001 2022 për prokurim publik.</p>

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Naim Shuki B.I.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për të sëmurit" me numër të prokurimit: "70010-23-5909-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SPITALI REGJIONAL - PRIZREN



Në mbështetje të Nenit 108/A par.10.1 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, duke u bazuar në Nenin 8 par.8.1.1 pika iii) lidhur me Nenin 7 par.7.1 pika d) të Rregullave për parashtrimin e ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të datës 08.12.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik NTP.Printeks Prizren për aktivitetin e prokurimit " Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për të sëmurit " me nr. të prokurimit: 70010-23-5909-1-2-1 nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit ekonomik " NTP.Printeks e datës 08.12.2023 kundër Njoftimi mbi vendimin e kontratë e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për të sëmurit " me nr. të prokurimit: 70010-23-5909-1-2-1
2. Vërtetohet Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit " Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për të sëmurit " me nr. të prokurimit: 70010-23-5909-1-2-1
3. Vazhdohet me aktivitetin e prokurimit " Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për të sëmurit " me nr. të prokurimit: 70010-23-5909-1-2-1

Ky Vendim mbetet në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën e eprokurimit për të gjithë palët e interesuar për aktivitetin e prokurimit në fjalë, adresa: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Arsyetim

Operatori Ekonomik NTP.Printeks - Prizren me datën 08.12.2023 si palë e pa kënaqur ndaj njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 18.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit " NTP.Printeks duke supozuar se janë shkelur dispozitat e Neni 1 i LPP-së Neni 59 i LPP -së Neni 60 i LPP

Autoriteti Kontraktues me datë 15.08.2023 ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku ka konstatuar si vijon:

Pretendimi ankimor

Fillimisht ju sqarojmë se arsyeja e autoritetit kontraktues është e paqartë dhe e pakuptueshme për ne për faktin se në arsyetimin e eliminimit nuk shënohet fare se çfarë gabimi ka mostra jonë pasi që nëse do të ishim të papërgjegjshëm, AK-ja do ta sqaronte me fakte dhe argumente konkrete ku një gjë e tillë nuk ka ndodhur arsyetime krejtësisht të pa bazuara.

POZ1 Ne si OE Deklarojm se plotsojm kushtet e ANKESII Dosjes Tenderit. Per matjet qe kane bere komisioni nuke eshte profesional dhe nuke jane qertifukar perr matje textitilit dhe nuke ka mundesi me dore te kuptohet se sa eshte perqindja e Poliester e sa Pambuk

POZ2 Ne si OE deklarojm se Permbajtja dhe ngjyre kerkuar ploteson kushtin ANEKSI1 DosjeJTenderit Per matjet qe kane bere komisioni nuke eshte profesional dhe nuke jane qertifukar per matje textitilit dhe nuke ka mundesi me dore te kuptehet se sa eshte perqindja e materialeve & ngjyra e kerkuar ne Aneksin 1 Dosjes Tenderit eshte vetem (Nuke eshte specifikuar me numer ngjyres apo Gjelbert e mbydhur ose hapur etj)

POZ5 Per LOGO ne mosra nuke kemi hasur ne asnje Tender te kerkohet logoja te qepet ne mosra perveq nese jemi Fitues kerkohen mosra me llogo dhe ceket ne Dosjen e tenderit ose kerkohet llogo te qepet veqanerisht ne nje material gjithashtu kerkohet ne dosjen e tenderit (ne te kunderten ne mosra kur qepen logoja per OE qe eliminohen nuke kane drejt te perdorin ato mosra sepse simbolizon nje institucion dhe gjithashtu ne si OE kemi humbje dhe duhet te paguhet nga AK dhe ceken ne Dosjen e tenderit.

(Kosove egziston nje institucion qe licencuar dhe certifikuar per matje ERAMED ne seli ne Prishtine per me shume (LC - 014 ERAMED NTP Akreditacija iarm.gov.mk)

Dhe deklarojm se 3 POZICION qe kemi dorzuar Mosrat plotesojn kushtin e Aneksit1 Dosjes se tenderit dhe kerkojm te behet rivlersimi dhe te mos shkelet Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskrimin

Te gjeturat e mostrave te OE “NAIM SHUKI”B.I.

Poz.1 Uniformë per personelin medicinal me ngjyre te bardhe.

- Pantallonat kane material tjetër nga bluzat,nuk eshte materiali i njeite (permbajtja me shume poliester

POZ.2Uniforma per salla te operacionit te gjelberta bluze dhe pantallona

- Bluza eshte sipas specifikave te kerkuara ,ndersa patallonat ne permbajtje dhe me ngjyre nuk i pershtaten ngjyres dhe kualitetit te bluzave (duhet te jene komplet me ngjyre dhe kualitet.)

POZ.5 jakne e gjate dimri me mbishkrim ne shpine dhe logo e qepur ne gjoks materiali 65% poliester 35% pambuk pjesa e brendshme me lio

-Mungon mostra me mbishkrimin dhe logon e spitalit.

Asnjera nga këto pozicione (Mostra) Nuk jan seipas kereses se AK

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Naim Shuki B.L.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për të sëmurit” me numër të prokurimit: “70010-23-5909-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SPITALI REGJIONAL - PRIZREN

Nga konstatimet e lartecekura u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, ankuesi mund të paraqes në çdo rast, një ankese pranë OSHP-së në pajtim me Nenin 109 të LPP-së brenda 10 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Data: 18.12.2023, Prizren

Menaxheri i Prokurimit

Mr.Sc.Sami Ahmetaj



INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA
EKSPERTI SHOYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Naim Shuki B.I.

Sqarim hyrës: Pretendimet të cilat janë ngritur nga OE ankues janë kryesisht pretendime ankimore me karakter teknik, eksperti shyqrtues ka pasur mundësi të përgjigjet vetëm në njërin pretendim si më poshtë.

Pretendimi 1 dhe 2

OE ankues pretendon që: “OE ankues është eliminuar padrejtësisht për disa arsye të dhëna nga AK. POZ1- Per matjet që kanë bërë komisioni nuk është profesional dhe nuk janë certifikuar për matje tekstilit dhe nuk ka mundësi me dore të kuptohet se sa është përqindja e Poliester e sa Pambuk. POZ2- 2 Dosje Tenderit Per matjet që kanë bërë komisioni nuk është profesional dhe nuk janë certifikuar për matje tekstilit dhe nuk ka mundësi me dore të kuptohet se sa është përqindja e materialeve & ngjyra e kërkuar në Aneksin 1 Dosjes Tenderit është vetëm Gjelbert (Nuk është specifikuar me numër ngjyres apo Gjelbert e mbyllur ose hapur etj.). Kështu që ngjyra dhe Materiali e përmbush kërkesën AK sipas Dosjes Tenderit ANEKSI 1.”

Sa i përket pretendimeve të ngritura nga OE ankues për dy arsyetimet e para të eliminimit nga AK, eksperti shqyrtues duke marr parasysh se nuk është i profilizuar si profesionist i materialeve dhe tekstilit, fillimisht ka bërë kërkesë për ekspert teknik të fushës përkatëse, por duke marr parasysh se OSHP momentalisht nuk ka ekspert të kësaj fushe, atëherë ankesa është dashur të trajtohej vetëm nga eksperti shqyrtues. Sa i përket këtyre dy pretendimeve të para, siç e cekta edhe më lartë eksperti shqyrtues nuk është i profilizuar profesionalisht për të shqyrtuar pretendimet sa i përket materialeve dhe përbërjes së tyre.

Pretendimi 3

“POZ5- Per LOGO në mosra nuk kemi hasur në asnjë Tender të kerkohet logoja të qepet në mosra përveq nëse jemi Fitueus kerkohen mosra me llogo dhe ceket në Dosjen e tenderit ose kerkohet llogo të qepet veqanerisht në një material gjithashtu kerkohet në dosjen e tenderit (në të kundërtën në mosra kur qepen logoja për OE që eliminohen nuk kanë drejt të përdorin ato mosra sepse simbolizon një institucion dhe gjithashtu në si OE kemi humbje dhe duhet të paguhet nga AK dhe ceken në Dosjen e tenderit. gjë e tillë nuk ka ndodhur me AK-në.”

Sa i përket pozicionit 5, në Dosje të Tenderit, tek pjesa e Aneksi 1- Specifikimet teknike të detyrueshme, është kërkuar që operatorët ofertues duhet të dorëzojnë *Jakne të gjatë dimri, me mbishkrim dhe shpinë dhe llogo e qepur në gjoks*. Një nga arsyet e eliminimit të OE ankues ka qenë edhe pse ky operator nuk ka ofruar mostrën e kërkuar me mbishkrimin dhe logon e spitalit. Nga pretendimi më lartë, shihet qartë se edhe vet OE ankues ka pranuar që nuk ka dorëzuar jaknen e cila e ka edhe llogon e spitalit sepse siç ceket nga operatori ankues, kur logo qepet nga një OE i cili eliminohet, e njëjta mostër nuk mund të përdoret diku tjetër sepse simbolizon një institucion dhe një gjë e tillë sjell humbje për operatorin. Sipas ekspertit, çdo kërkesë e DT-së duhet përmbushur nga operatorët pjesëmarrës, mospërmbushja e kërkesave të DT-së, tregon joseriozitet të operatorëve dhe mundëson edhe eliminimin nga aktiviteti i prokurimit. Duke qenë se OE ankues e pranon edhe vet përmes ankesës se nuk ka dorëzuar jaknen me logo ashtu siç është kërkuar, atëherë mendimi i ekspertit shqyrtues është se OE

ankues nuk ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nga kjo që arsyetuar, konsiderojmë që ky pretendim nuk është i bazuar.

Nga ajo çfarë shpejguam më lartë, eksperti edhe njëherë thekson se edhe pse nuk mund të ipen përgjigje në dy pretendimet e para, duke marr parasysh se për pozicionin numër 5, OE ankues nuk i ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit, atëherë edhe eksperti konsideron që kjo pikë është arsye e cila nuk e bënë të përgjegjshëm operatorin ankues.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Naim Shuki B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për të sëmurit**” me numër të prokurimit: “**70010-23-5909-1-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **SPITALI REGJIONAL - PRIZREN**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **SPITALI REGJIONAL - PRIZREN**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Naim Shuki B.I.**

Agnese Ibrahimi

